



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot .

Patos, më 12/03/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Rehabilitim dhe rikonceptim i lulishtes pranë stadiumit"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimore kodi 45

VLERA E FONDIT LIMIT:

11,666,406 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtë) lekë pa TVSH, për procedurën me objekt “**Rehabilitim dhe rikonceptim i lulishtes pranë stadiumit**”, vënë në dispozicion nga Të ardhurat Lokale 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **4,666,562.4 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë katër) lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi Limit: 11,666,406 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtë pikë dy) lekë pa TVSH

11,666,406 x 40% = 4,666,562.4 vlera e xhiros se kerkuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore

është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësaj, prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

11,666,406 x 30% = 3,499,921.8

Shënim: *(Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

2.3.2. Liçensat profesionale te shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, referuar preventivit të punimeve si dhe llojit të punimeve të parashikuara në të duhet të ketë këto pika në licencën profesionale :

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime gjurmimi në tokë. “Kategoria A”
- b. NP-11: Ndërtime për nënstacionet, kabinetat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. “Kategoria A”
- c. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve “Kategoria A”
- d. NS-18: Punime topogjeodezike “Kategoria A”

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

➤ **NP-1: Punime gjurmimi në tokë** “Kategoria A”

Konsiderohen gjurmimet, sistemet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

➤ **NP-11: Ndërtime për nënstacionet, kabinetat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.** “Kategoria A”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri të përdoruesit të energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji të tensionit, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

➤ **NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve** “Kategoria A”

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi

“hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

➤ **NS-18: Punime topogjeodezike.**

“Kategoria A”

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi ne toke	<p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p> <p>Transport dheu me auto deri 2.0 km</p> <p>Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme</p> <p>Germim dheu me krah per gropa pemesh</p> <p>Transport dheu me auto deri 2.0 km</p> <p>Germim dheu me ekskavator zinxhir 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p>	Kategoria A	

		Transport dheu me auto deri 3.0 km		
NP-11	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V ndricues projektor me llampe SAP-T 250 w. F.V.tubo plastike Ø63 F.V.tubo plastike Ø32 F.V.shtylla dekorative ndricimi me llambe LED 60 w, h=4 m F.V.puseta elektrike kontrolli PVC 20x20x20cm F.V kuader komandimi komplet me santeri dhe fotoelement F.V elektroda tokezimi te xingurara profil; l=150m F.V percjelles tokezimi bakri Cu-10 mm2 F.V Kabell Cu 4x4 mm2 F.V Kabell Cu 3x 2.5mm2 Germimi dheu per gropa shtyllash dhe kanalin e kablove Mbushje me rere F.v tub PVC Ø 150 mm Shtrese betoni C16/20 per fiksime tubi pvc - 150mm	Kategoria A	
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje struktura prej betoni Cmontim rrjete metalike te rrethimit te fushave	Kategoria A	
NS-18	Punime topogjeodezike	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit Trotuar me 10 cm beton + lluster çimento me pigment F.V Bordura betoni 12x25	Kategoria A	

		Shtrese betoni C 7/10 per fiksim bordure		
		Shtrese çakelli t=8cm, perhapur e ngjeshur me makineri		
		Shtrese stabilizanti t=5 cm		
		F.V Baze gome 5 cm		
		Shtrese gome e derdhur ngjyre e kuqe 2 cm		
		Shtrese gome e derdhur ngjyre bojeqelli 2 cm		
		F.V Paralele teke, set me 3 seksione		
		F.V Cift paralelesh per ushtrime		
		F.V Stacion i dyfishte per muskujt e kofsheve		
		F.V Stacion lavjerres per trupin		
		F.V Stol force per ushtrimet e barkut		
		F.V Stacion I dyfishte per muskujt e shpines		
		F.V Stacion biciklete per humbjen e peshes		
		F.V Stacion i dyfishte per muskujt e kraharorit		
		F.V Stacion i dyfishte per muskujt e kembeve		
		F.V Stacion lisharese me 4 vende		
		F.V Stacion lekundese dyshe per femije		
		F.V Stacion rrotullues per femije me 3 ndenjese		
		F.V Loder lekundese ne forme makine		
		F.V Loder lekundese ne forme kali		
		F.V Stacion loje multifunksionale per femije		
		F.V Tavoline ping-pongu		
		Rrafshim ngjeshje dheu ne kodrinat me bar artificial		
		F.V tapet bari artificial 8mm PP		

		F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm		
		F.V. Fidane Peme dekorative (Magnolia)		
		F.V. Fidane Peme dekorative (kumbull e kuqe)		
		F.V. Fidane shkurre dekorative		
		Bordure betoni 6x20 per pemet		
		Mbjellje bari		
		Shkembinj natyral		
		F.V Kosha mbeturinash te vegjel lulishteje		
		F.V Stola betoni kombinuar me ulese druri		
		F.V Gardh rrethues druri		
		Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize zgare		
		F V tub drenazhi Ø 150 mm		
		F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm (perfshire reren)		
		Ndertim drenazhi, mbushje me zhavor		
		Gjeotekstil me gramature 180 g/m2		
		F.V Shtrese niveluese elastike sportive lloji MAPECOAT TNS Grey Base Coat 3 mm (ose ekuivalent)		
		F.V Tapet rezine sintetike me ngjyra per terrene sportive Mapecoat TNS (ose ekuivalente)		
		Vije zime me boje resina acrelica Mapecoat TNS Line d=8 cm me tre ngjyra sipas seciles disipline		
		Rrethim me rrjete teli. (rrethimi deri ne lartesine 4m me rrjete metalike ne forme rombi 50 mm x 50mm me peshe 4kg /m ² me fije celiku 2.9 mm e galvanizuar dhe e plastifikuar)		

		Konstruksione metalike te thjeshta per rritje te lartesis se konstruksioni mbajtes te rrethimit te fushave		
		Germim dheu per themel		
		Struktura monolite betoni C 16/20		
		F.V hekur betoni per murin		
		Shtrese zhavori t=10 cm nen themel		

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në baze të VKM-se Nr. 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| a. Inxhinier ndertimi | 1 (një) |
| b. Inxhinier gjeodet Gjeodet/Topograf/Markshajder | 1 (një) |
| c. Inxhinier elektrik | 1 (një) |

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e ne vazhdim. ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e ne vazhdim. Ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Argumentimi: Mbeshtetur në klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" sipas se ciles shoqeria merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë nepermjet nje eksperti i cili do te jete i gatshem ne sistemin e ndihmes se pare duke pasur njohuri te pergjithshme mbi patologjite ne mjediset e punes.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (një)** per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim.
- b. **Hekurkthyes 1 (dy)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim.
- c. **Pllaka shtrues 4 (tre)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim.
- d. **Elektriciist 1 (një)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente)dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim
- e. **Puntore te thjeshte 7 (shtatë)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim.
- f. **Shofere 4 (katër)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- g. **Manovratore 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Nëntor 2023 e në vazhdim. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për punonjesit automakinist, ofertuesi duhet të paraqesë:

-kontratën individuale të punës te vlefshme;

-leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit shofer dhe automakinist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinier elektrik** është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndertimit të objektit për zërat e punimeve të fushës së tij, zberthimin e sakte të projektit, punimet e sistemit elektrike dhe për cilësinë e materialeve elektrike si psh kablo, priza, celesa etj.
- **Inxhinieri gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi për realizimin e sakte të kuotave dhe shtresave të rruges, kuotave të nenshtresave të rruges, dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit të ujrave të shiut në trupin ose në anet e rruges.
- **Teknike ndertimi** (ose inxhinier ndertimi në zbatim) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në kantierin e projektit objekt prokurimi për realizimin e sakte të kuotave dhe shtresave të rruges, kuotave të nenshtresave, dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit të ujrave të shiut në trupin ose në anet e rruges.
- **Hekurkthyesi** është përgjegjës për kthimin dhe lidhjen e sakte të hekurit dhe vendosjen e datajeve metalike në strukturat b/a të përfshira në objektin që prokurohet.
- **Elektriçist** është personi përgjegjës për kryerjen e të gjitha punimeve të instalimeve elektrike në objekt sipas projektit të paraqitur, për materialet të cilat vendosen në veper për objektin që prokurohet.
- **Pllaka shtruesi** është përgjegjës për vendosjen e sakte të bordurave të parapergatitura apo të derdhura në vend, për shtrimin e sakte të pllakave të parapergatitura për trotualet e përfshira në objektin që prokurohet.
- **Specialist për shtresat rrugore** është përgjegjës për ndërtimin e sakte të shtresave asfaltike (të ndërtuara me binder dhe/ose asfaltobeton) dhe nenshtresave rrugore (të ndërtuara me material guri natyror dhe/ose të parapergatitur) të përfshira në objektin që prokurohet.
- **Shofere** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantier dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet. Në rastet kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës do të jenë të kontraktuar.
- **Manovratore** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive dhe pajisjeve të ndertimit në kantier dhe jashtë kantierit për kryerjen e proceseve të caktuara të punëve (psh. presa/pompa betoni, ekskavatore gërmim, mini fadroma, skre të llojeve të ndryshme etj) të

nevojshme për objektin që prokurrohet. Në rastet kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës do të jenë të kontraktuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit. **Shënim: Argumetimi i nr. të punonjeseve behet vetëm me qellim për justifikimin e stafit të kërkuar. Ndarja sipas specialiteteve në këto rubrike të mos merret në konsideratë në plotësimin e kritereve të percaktuara.**

Në rastet kur makinerit disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listpagesën e shoqërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 22 (njëzet e dy) persona**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) Vertetim të leshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës ose me vule elektronike.
- b) Listpagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 25)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- *Teknike ndertimi* 1 (një)
- *Hekurkthyes* 1 (nje)
- *Elektriçist* 1 (nje)
- *Pllaka Shtrues* 4 (katër)
- *Puntore te thjeshte* 7 (shtatë)
- *Shofere* 4 (katër)
- *Manovratore* 1 (nje)
- *Drejtues Teknik* 3 (tre)

TOTALI = 22 Persona ne Staf (njëzet e dy).

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndaria sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterave te percaktuara.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** copë 2 (dy)
- **Kamiocine me kapacitet mbajtës (4 deri ne 6 ton)** copë 2 (dy)
- **Ekskavator me goma** copë 1 (nje)
- **Rul me vibrim** copë 2 (dy)
- **Autobot uji me kapacitet mbajtës mbi 5000 litra** copë 1 (një)
- **Rul me kompresor** copë 1 (një)
- **Autobetoniere** copë 1 (një)
- **Pompe betoni** copë 1 (një)
- **Vibrator betoni thellesie** copë 1 (nje)
- **Autovinc me peshëngritje mbi 2.5 ton** copë 1 (një)
- **Gjenerator 3.5 KVA** copë 1 (një)

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,

- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Percaktimi i numrit te punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar mbi analizat e zerave te preventivit objekt prokurimi me qellim realizimin me sukses te procedures, sipas legjislacionit të fushës sipas analizes se mesiperme.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat ISO:

- ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- a) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushton aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- a) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi:

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), si dhe ne Kodin te punes, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe ne mbeshtetje te natyres se objektit te prokurimit.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses

të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Specifikimet teknike janë bere per permbushjen e nevojave te Autoritetit Kontraktor. Materialet i kane specifikimet e tyre cilesore dhe sasiore sipas zerave te secilit ne preventive dhe ne specifikimet teknike.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga **DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN, PROJEKTEVE, SHËRBIMEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE** duke marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **25/03/2024, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Rehabilitim dhe rikonceptim i lulishtes pranë stadiumit”,**

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT: